

Statistikat e transportit

Qershor, 2018

Tiranë, më 27 Korrik 2018: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Qershor 2018 është 277 mijë ton, duke u ulur 14,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.940 mijë ton, duke u ulur me 0,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.584 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 34,8 % krahasuar me Qershor 2017.

Për gjashtëmuajorin e parë 2018, ky volum është 8.300 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 33,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Qershor - 2017	325.625	2.430	194
Qershor - 2018	277.171	1.584	175
Ndryshimi vjetor (%)	-14,9	-34,8	-9,8
Janar - Qershor 2017	1.947.476	12.462	1.101
Janar - Qershor 2018	1.940.434	8.300	1.075
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-0,4	-33,4	-2,4

* Përfshin mallrat dhe postën

Në muajin Qershor 2018, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 175 ton.

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, me ajër janë transportuar 1.075 ton mallra, duke u ulur 2,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë 2017.

Numri i fluturimeve të kryera, në Qershor 2018, është 2.314 duke shënuar një rritje me 13,1%, ndaj Qershor 2017.

Për publikim 27/072017

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, janë kryer 11.774 fluturime, duke u rritur me 9,6 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Qershor - 2017	18	2.046	17.482
Qershor - 2018	22	2.314	19.773
Ndryshimi vjetor (%)	22,2	13,1	13,1
Janar - Qershor 2017	18	10.742	68.698
Janar - Qershor 2018	22	11.774	75.067
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	22,2	9,6	9,3

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Qershor 2018 është 133.037 pasagjerë, krahasuar me Qershor 2017, ky tregues është rritur 10,0 %.

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, kanë udhëtuar me linjë detare 445.588 pasagjerë, duke u ulur me 4,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, transporti ajror i pasagjerëve zë 72,7 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në gjashtëmuajorin e parë 2018 është 1.270.329 duke u rritur me 13,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Qershor - 2017	8.982	120.984	229.584
Qershor - 2018	7.282	133.037	277.693
Ndryshimi vjetor (%)	-18,9	10,0	21,0
Janar - Qershor 2017	24.439	466.534	1.120.326
Janar - Qershor 2018	30.828	445.588	1.270.329
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	26,1	-4,5	13,4

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Qershor 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 81 mld lekë dhe 53,6 % e tyre u transportua me det.

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 467 mld lekë dhe 54,4 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave


Në Qershor 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 57,4 %, me rrugë 38,6 % dhe me ajër 0,4 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në Qershor 2018, janë rritur me 23,7 % dhe me ajër janë ulur me 36,0 %, krahasuar me Qershor 2017.

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 58,8 %, me rrugë 34,6 % dhe me ajër 0,4 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në gjashtëmuajorin e parë 2018, janë rritur me 17,8 % dhe me hekurudhë janë ulur me 15,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2018



Importet e mallrave


Në Qershor 2018, mallrat e importuara me det zënë 51,7 %, me rrugë 44,7 % dhe me ajër 2,6 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në Qershor 2018, janë ulur me 57,3 % dhe me det janë ulur me 3,1 %, krahasuar me Qershor 2017.

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, mallrat e importuara me det zënë 52,2 %, me rrugë 42,9 % dhe me ajër 2,8 %.

Mallrat e importuara me rrugë, në gjashtëmuajorin e parë 2018, janë rritur me 2,5 % dhe me hekurudhë janë ulur me 26,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2018



Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë